



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:266762

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06734319

KPPP.nr. 1463/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë me seli në Prishtinë, kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me nr. të biznesit 811288001 dhe me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2524/24 të datës 09.09.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Curri me zyre në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 2524/24 i datës 09.09.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Curri, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 09.09.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 2524/24 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit - Aktvendim nr. 01/48-08/2023GJ të datës 24.04.2024 ashtu që është detyruar debitori Telekom i Kosovës Sh.A. që në emër të gjobës administrative të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur t'ia paguaj kreditorit t'ia paguaj shumën e borxhit prej 3,500.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor përmes të së cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ka pësuar ndryshim përmes Ligjit nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin

nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative – faza e dytë e sipas të cilave ndryshime, vendimi i organit administrativ më nuk përbën titull ekzekutiv mbi bazen e të cilit mund të lejohet përmbarimi.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje ndaj prapësimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e pranoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Me Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, neni 22 par.1.2 të saj fillimisht ka qenë e përcaktuar që si dokument përmbarues paraqitet “*vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktgjatimi (më tej: ujdia)*”.

Ndërsa, me Ligjin nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – faza e dytë, Kapitulli XXIV që i referohet ndryshimeve të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me nenin 77 është përcaktuar se “*Paragrafi 1.2. i nenit 22 të ligjit bazik fshihet*”.

Nga ndryshimet e lartcekura, rezulton se vendimi i organit administrativ që përbën detyrim monetar, tanimë nuk përbën më titull ekzekutiv dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Rrjedhimisht, meqenëse propozimi për përmbarim nga kreditore është iniciuar me datë 09.09.2024, ndërsa ndryshimet e LPP-së përmes Ligjit nr. 08/L-262 kanë hyrë në fuqi me datë 23 gusht 2024, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të Ligjit 08/L-262 në Gazetën Zyrtare, rezulton se në kohën e paraqitjes së propozimit për përmbarim dhe lejimit të përmbarimit, dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka paraqitur titull ekzekutiv e rrjedhimisht nuk përbën bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga këto të gjetura, e në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par. 1.1 të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse “*dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë*”, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 71 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1463/24 datë 21.01.2025

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.